



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U "Nënë Tereza" kërkon të punësojë **1 (një) Përgjegjës në Zyrën e Radiombrojtjes, të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsim i larte, niveli Master shkencor në Fizikë Mjekësore. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të jetë ekspert i njohur nga Komisioni Kombëtar i Mbrojtjes nga Rrezatimi Jonizues
- Të paktën 3 vjet në pozicionin e fizikanit mjekësor.
- Njohuri shumë të mira në fizikën mjekësore, në parametrat për ndërtimin e kabineteve, radioterapi, mjekësi bërthamore dhe radiologji
- Të jetë i çertifikuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
- Të njohë mirë legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e KMR
- Të njoh shumë mirë procedurat administrative;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet
- Aftësi të mira komunikimi.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV), në gjuhën shqipe
3. Diplomën/at e arsimit të lartë dhe listën/at e notave të noterizuar/a
4. Çertifikatën e njohjes nga KMR (noterizuar)
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
7. (<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU "Nënë Tereza" **deri më 03.09.2021 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE